

RAPORT MONITORIMI MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

(12 mujori 2011)

Detajimi i buxhetit për vitin 2011 është mbështetur në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë si dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2011-2013, sipas 6 programeve buxhetore ose niveleve arsimore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimi i synuar, përfituesit, si dhe lidhjet midis politikave sektoriale dhe aktiviteteve nga ku janë përcaktuar dhe buxhetet për çdo program, të parashikuara në PBA për periudhën 2011-2013.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për vitin 2011, administron dhe menaxhon fondet buxhetore, sipas gjashtë programeve të miratuara, të listuar me poshtë:

1. Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”
2. Programi “Arsimi Bazë”
3. Programi “Arsimi i Mesëm i Pergjithshëm”
4. Programi “Arsimi i Mesëm Profesional dhe Social-kulturor”
5. Programi “Arsimi i Lartë”
6. Programi “Kërkimi shkencor”.

Buxheti i miratuar me ligjin nr. 10355 datë 02.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, ishte planifikuar 40 miliard e 394 milion lekë, nga të cilat 35 miliard e 484 milion lekë shpenzime korrente dhe 4 miliard e 910 milion lekë investime.

Buxheti i miratuar për vitin 2011, ka një rritje mesatare vjetore prej 5.2 % ndaj buxhetit të realizuar për vitin 2010.

Buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe -Shkencës për vitin 2011, i detajuar sipas grup artikujve;

- a) Shpenzimet për personelin janë 27.2. miliard lekë ose 67% e buxhetit të miratuar për vitin 2011.
- b) Shpenzimet operative për blerjen e mallrave dhe shërbime janë 8.28 miliard lekë ose 21%.
- c) Shpenzimet kapitale për investime janë 4.9 miliard lekë ose 12%. Sipas burimit të financimi shpenzimet kapitale janë të financuara;

Sipas burimit të financimit fondet për investime kapitale janë sa vijon;

- a) Nga buxheti i shtetit janë 2.7 miliard e lekë me 7% të buxheti ose 55% e fondit të investimeve.
- b) Me Financim të huaj në shumën 2.2 miliard lekë me 5% të buxhetit ose 45% të fondit të investimeve. Burimi i financimit janë Banka Botërore dhe Bankat Evropiane në kuadër të projektit “Cilësi dhe barazi në arsim”, si dhe financime të tjera nga Projekti IPA BE, KE Projekti CARDS, Qeveria Zvicerane, Qeveria Italiane.

Buxheti i rishikuar me ligjin nr. 10450 datë 14.07.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10355, datë 02.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, është **38 miliard e 304 milion lekë**, nga të cilat 34 miliard e 141 milion lekë ose 89.1% janë shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale/investime janë 4 miliard e 163.4 milion lekë ose 10.9% e fondeve për vitin 2011. **Buxheti i rishikuar** për vitin 2011, ka një rritje mesatare vjetore prej 3.9 % ndaj buxhetit të realizuar për vitin 2010.

Buxheti I rishikuar i Ministrisë së Arsimit dhe -Shkencës për vitin 2011, i detajuar sipas grup artikujve;

- a. Shpenzimet për personelin janë 27.29 miliard lekë ose 82 % e buxhetit të rishikuar për vitin 2011.
- b. Shpenzimet operative për blerjen e mallrave dhe shërbime janë 4.4 miliard lekë ose 7%.
- c. Shpenzimet kapitale për investime janë 4.16 miliard lekë ose 11 %.

Sipas burimit të financimit fondet për investime kapitale janë sa vijon;

- c) Me financim nga buxheti i shtetit janë 2.14 miliard e lekë ose 51.4% e fondeve të investimeve.
- d) Me financim të huaj janë 2.02 miliard lekë ose 48.6% të fondeve të investimeve. Burimet i financimeve të huaja janë Banka Botërore dhe Bankat Evropiane në kuadër të projektit “Cilësi dhe barazi në arsim”, si dhe financime të tjera nga Projekti IPA BE, KE Projekti CARDS, Qeveria Zvicerane, Qeveria Italiane.

- A. **Për shpenzime për personelin në artikullin 600-601**, janë planifikuar 27.29 miliard lekë ose 82 % e e fondeve të buxhetit të miratuar për MASH. Fondet e miratuara mbulojnë për shpenzime personeli pagat dhe sigurimet shoqërore të 39,028 punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar si dhe punonjësve që institucioneve të sistemit të MASH. Këto fonde kanë mbuluar atërisht rritjen e pagave të miratuar në 6mujorin e dytë për vitin 2011, si dhe ndryshime apo strukturimin të institucioneve të sistemit arsimor.
- B. **Për shpenzime te tjera korrente të funksionimit si dhe blerje materiale, janë planifikuar 4.4 miliard lekë ose 7 %**; Zërat kryesorë në shpenzimet e tjera korrente janë shpenzime për transportin e nxënësve që kanë në zonat rurale si dhë mësuesve, shpenzime për trajnimin e pëersonelit si dhe punonjësve mësimore, shpenzime për blerje mjete didaktike, shpenzime për transfertat tek individët për blerjen e tekstet shkollore, shpenzime për krijimin e krijimin e kushteve të punës (shpenzime për energji elektrike, ujë, internet, telefon, materiale zyre kancelari etj), bursat e nxënësve dhe studentëve etj, të cilat zënë edhe pjesën më të madhe të kësaj kategorie të shpenzimeve, si dhe transfertat e pakushtëzuar shpenzime e funksionimit të shkollave të larta. Në këtë grup shpenzimesh përfshihen dhe fondet që marrin IAL në formën e transfertës së pakushtëzuar, dhe që pas vendimarrjes në organet e tyre kolegjiale detajohen në shpenzime personelit ku përfshihen dhe fondi i pagave e sigurimeve shoqërore, si dhe shpenzime të tjera funksionale.
- C. **Investime kapitale për artikullin 230-231**, janë planifikuar 4.163 miliard lekë ose 11% e buxhetit të MASH; Fondi i planifikuar për investime 2011, sjell ndryshime në infrastrukturën e arsimit parauniversitar në drejtim të arritjes së standartit 30-32 nxënës për klasë, pajisjes së të gjitha shkollave me laboratorë informatike, laboratore të shkencave natyrore, përmirësimit të gjendjes së pajisjeve shkollore etj. Një analizë më e detajuar për **Investimet kapitale sipas programeve buxhetore për vitin 2011**;

Realizimi i fondeve buxhetore për vitin 2011, ndaj planit vjetor është në masën 96%, krahasuar me realizimin e shpenzimeve për vitin 2010 janë rreth 104 milion lekë më shumë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për vitin 2011 rezulton si më poshtë:





Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime korente	98.1 %
<u>Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale</u>	<u>74.4%</u>
Gjithsej	96.0 %

Tab_1, Fondet buxhetore sipas programeve buxhetore të miratuar për vitin 2011, (buxheti 2011 në mijë lekë).

Nr	Emri i programit	Buxheti	Struktura		Realizimi 12 mujor 2011	
		Rishikuar	Ne %	Ne milion /lekë	Struktura ne % ndaj buxh total	Struktura ne % ndaj realizim
		(milion lekë)				
1	Planif. menaxhim administrim	807.6	2.1%	740.6	92%	2.0%
2	Arsimi baze	23,636.3	61.0%	22,872.3	97%	61.7%
3	Arsimi i mesem i pergjithshem	5,267.3	13.6%	5,137.2	98%	13.9%
4	Arsimi i mesem profesional	2,315.5	6.0%	1,922.0	83%	5.2%
5	Arsimi i larte	6,203.7	16.0%	5,957.4	96%	16.1%
6	Kerkimi shkencor	544.2	1.4%	416.4	77%	1.1%
Totali		38,774.6	100.0%	37,045.9	96%	100.0%

Tab_2,
Struktura e buxheti 2010 sipas grup artikujve buxhetore në %;
%;

Tab_3
Struktura e buxhetit të planifikuar për vitin 2011 sipas programeve buxhetore në %;



Tab_4 Fondet buxhetore sipas grup artikujve të planifikuara në PBA 2011, të miratuara për vitin 2011, planit të rishikuar, si dhe realizimi faktik për 12 mujorin Janar –Dhjetor 2011 në mijë lekë dhe në %.

Artikulli Kodi	Emri	PBA Plan 2011	Buxheti Fillestar 2011	Buxheti i Rishikuar 2011	Realizimi 12 mujor 2011	Diferenca Realiz-Buxh rish2011	Realizimi 12 mujor ne % 2011
600-601	Paga+Sigurime Shoqërore	27,485,000	27,200,000	31,691,075	31,209,995	-481,080	98%
602-606	Mallra dhe Shërbime të Tjera	8,084,000	8,284,457	2,920,199	2,738,108	-182,090	94%
230-231	Kapitale të Trupezuara Patrupëzuara	5,869,000	4,910,000	4,163,370	3,097,777	-1,065,593	74%
Totali	Korrente dhe Kapitale	41,438,000	40,394,457	38,774,643	37,045,880	-1,728,764	96%
<i>Jashte Buxhetore</i>		0.0	0.0	2,955,639.6	2,946,622.2	-9,017.4	100%
Totali	(korrente + kapitale + jashte buxhetore)	41,438,000	40,394,457	41,730,283	39,992,502	1,737,781	96%

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkencës konfirmuar nga Ministria e Financës

Tab_5 Fondet e planifikuara për vitin 2011 sipas burimit të financimit dhe programeve arsimore, si dhe realizimi faktik për 12 mujorin Janar – Dhjetor **2011 në mijë lekë dhe në %**.

Plani I Shpenzimeve Kapitale per vitin 2011				Realizimi I Shpenzimeve Kapitale per vitin 2011					
Programi buxhetor	Nga Buxheti	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	Realizimi 2011 Financim nga Buxheti	Realizmi ne % ndaj planit 2011	Realizimi 2011 nga Financim Huaj	Realizmi ne % ndaj planit 2011	Totali i Shp. Kapitale	Realizmi ne % ndaj planit 2011
Totali	2,139,008	2,024,362	4,163,370	1,759,334.2	82%	1,338,608.6	66%	3,097,942.8	74.4%
01110	43,300	44,000	87,300	17,272.9	40%	30,737.1	69.9%	48,010.0	55.0%
09120	1,155,118	1,104,946	2,260,064	992,495.41	86%	810,055.5	73.3%	1,802,550.9	79.8%
09230	385,435	365,989	751,424	303,157.31	79%	365,989.0	100.0%	669,146.3	89.1%
09240	203,611	301,000	504,611	174,230.97	86%	-	0.0%	174,231.0	34.5%
09450	351,544	208,427	559,971	272,177.62	77%	131,827.0	63.2%	404,004.6	72.1%
09770	0	0	0	-	0%	-	0.0%	-	0.0%

Tab_6 Fondet e planifikuara në kuadër të aktiviteteve të Porjektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, sipas donatorëve në Euro , realizimi për periudhën 2006-2011 në %, diferenca per tu realizuara 2012-2013 në Euro dhe në %.

Donator	Kontributi sipas donatoreve	Kontributi donatoreve ne %	Fondet e disbursuara deri ne 30.12.2011	% e disbursimit, ndaj Kontributit total	Realizimi progresiv I shpenzimeve 2006-31.12.2010	% e realizimit deri 31.12.2010	Realizimi faktik shpenzimeve per vitin 2011	% e realizimit 2011	Realizimi progresiv I shpenzimeve 2006-2011	Realizimi progresiv ne % 2006-2011	Diferenca e Kredise per tu realizuar 2012-2013	Diferenca e Kredise per tu realizuar 2012-2013 ne %
A	B	C	D	F=C+D	G=A-F							
ËB	11,033,333	19%	7,939,196	72%	3,514,600	32%	3,824,596	35%	7,339,196	67%	3,694,137	33%
BEI	12,500,000	21%	8,543,062	68%	3,910,780	31%	3,638,235	29%	7,549,015	60%	4,950,985	40%
CEB	14,000,000	23%	6,720,000	48%	3,382,322	24%	3,337,678	24%	6,720,000	48%	7,280,000	52%
GoA	22,066,667	37%	12,207,102	55%	10,167,706	46%	2,102,396	10%	12,207,102	55%	9,859,565	45%
Total	59,600,000	100%	35,409,360	59%	20,975,408	35%	12,902,905	22%	33,878,313	57%	25,721,687	43%

Në mënyrë më analitike sipas gjashtë programeve buxhetore, realizimi i buxhetit dhe produkteve të parashikuara për periudhën 12 mujore 2011, paraqitet sa vijon;

I - PLANIFIKIM-MENAXHIM. (Titulli i programit 0111)

Buxheti i rishikuar për këtë program është **807.6 milion dhe zë rreth 2.1%** të buxhetit të MASH. Realizimi për periudhën 12 mujore është 740.6 milion lekë, realizimi në këtë program është në masëm **92%** ndaj planit vjetor **dhe zë rreth 2.1% të fondeve të MASH ose 2%** të fondeve të realizuara për vitin 2011 në totalin e fondeve të realizuara të MASH

Objektivat kryesore:

1. Forcimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese, nëpërmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese me 20-25% të punonjësve në MASH, DAR dhe ZA.(për 150 punonjës).
2. Përmirësimi i kushteve të punës, për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në punë, nëpërmjet sigurimit të shërbimeve bazë (materiale, energji, internet, telefon ngrohje etj), si dhe rinovimit të paisjeve e aseteve të qëndrueshme me 10-15% në vit, pajisjeve të zyrave, pajisje teknologjike, rikonstruksionin/zgjerimit e objekteve ekzistuese, si dhe ndërtimeve të reja.
3. Krijimi i sistemit të informacionit (EMIS Faza e I-rë) në përputhje me standardet operacionale në arsim, nëpërmjet shtrirjes dhe funksionimit të sistemit EMIS në të gjithë DAR/ZA.
4. Përfrimi i legjislacionit kombëtar me atë të BE (acquis communautaire).

5. Rritja e aftësive vlerësuese dhe vetëvlerësuese në sistem, duke ndërtuar një sistem të qëndrueshëm e transparent monitorimi, në planifikimin dhe përdorim e burimeve njerëzore, financiare dhe materiale në arsim. Auditimi dhe inspektimi i 30% të institucioneve arsimore, mbështetur në praktikën më të mira ndërkombëtare.
6. Trajnimi i **110 drejtuesve** të shkollave për realizimin e autonomisë shkollore në funksion të decentralizimit i shërbimit arsimor, si dhe rritjes të autonomisë së shkollave duke fuqizuar kapacitetet planifikuese dhe menaxhuese në shkollë.

Arritje 2011

- ◆ Sistemi për Menaxhimin Financiar ka kryer informatizimin e proceseve financiare në MASH dhe është instaluar në Drejtoritë Arsimore rajonale –DAR. Projekti është shtrirë në të gjithë vendin.
- ◆ Moduli SIMS që pritet të finalizohet brenda tremujorit të parë të 2012: për herë të parë po ndërtohet një sistem që do të përbajë databazën e plotë për të gjitha të dhënat e infrastrukurës dhe inventarizimin e shkollave.
- ◆ Moduli GIS që pritet të finalizohet brenda tremujorit të parë të 2012: ky aplikacion do të bëjë të mundur pozicionimin në hartë të shkollave dhe ka caktuar për çdo objekt shkollor një pozicion gjeografik në databazën e modulit SIMS në mënyrë që të ndihmojë vendimarrësit në procedurat e planifikimit të investimeve për infrastrukurën dhe objektet shkollore.

Shpenzimet korrente sipas planit të rishikuar janë 720.3 milion lekë (7.2 milion usd).

Zëri 600-601 *Pagat dhe sigurimet shoqërore* janë planifikuar në shumën 550.2 milion lekë dhe janë realizuar në masën 527.6 milion lekë ose 96 % e fondeve të realizuar për 665 punonjës nga të cilët 656 punonjës me kohë të plotë dhe rreth 10 punonjës me kohë të pjesëshme (janë miratuar rreth 40 punonjës me kohë të pjesëshme 3-4 orë në ditë në shërbim sanitar në DAR/ZA);

- a) Aparati i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës 116 punonjës,
- b) Drejtoritë Arsimore Rajonale, 13 drejtori me 270 punonjës e specialistë
- c) Zyrat Arsimore në Rrethe, 25 zyra me 240 punonjës e specialistë;
- d) Inspektoriati Kombëtar i Arsimit Tiranë me 30 punonjës

Zeri i shpenzimeve operative (artikulli 602-606), janë planifikuar 170.2 milion lekë dhe janë realizuar në shumën 165 milion lekë ose në masën 97%, nga të cilat:

- ✚ shpenzime për krijimin e kushteve të punës dhe funksionimin e Aparatit të MASH rreth 44.7 milion lekë, realizimi 44.7 milion lekë ose 100% e fondeve të planifikuara;
- ✚ shpenzime në kuadër të projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, prioriteti parë, në shumën 24.9 milion lekë (për trajnimin e punonjësve të MASH, DAR, ZA në kuadër të sistemit EMIS, trajnimi i drejtorëve të shkollave, trajnimi i specialistëve të sektorit të prokurimeve, sektorit të buxhetit/investimeve analitike, më e detajuar në prioritetin 1 plani i aktiviteteve të miratuara për vitin 2011), dhe janë realizuar në shumën 20.2 milion lekë ose në masën 81.2%.
- ✚ shpenzime për funksionimin e 13 DAR në vlerën 37 milion lekë dhe 25 ZA, në vlerën 51.8 milion lekë të institucioneve të vartësisë, realizimi është në shumën 89.2 milion lekë ose në masën 100%,
- ✚ shpenzime për krijimin e kushteve të punës dhe funksionimin e Inspektoriatit Kombëtar të Arsimit Tiranë, në vlerën 8.9 milion lekë, realizimi është në shumën 8.9 milion lekë ose në masën 100%,
- ✚ shpenzime për transfertë tek individët, për kompensimin e shpenzimeve të karburantit për zëvendësministrat dhe sekretarin e përgjithshëm në vlerën 1.6 milion lekë dhe janë realizuar 1.5 milion lekë, ose në masën 100%,

Shpenzimet kapitale sipas planit kapin vlerën 87.3 milion lekë, me projektet kryesore:

- ✚ Rehabilitime të zyrave të drejtorive arsimore në vlerë **17.6 milion lekë**, të realizuara në shumën **14.85 milion lekë**, ose në masën 84%.
- ✚ Pajisje për DAR/ZA dhe MASH në shumën **6.68 milion lekë**, realizuar për **2.13 milion lekë**, ose në masën 31.9%.
- ✚ Hartim dhe dizajnim projektsh të reja **390 mijë lekë**, realizuar **390 mijë lekë**
- ✚ Sistemi EMIS për DAR/ZA dhe MASH, blerje pajisje elektronike dhe softë, në kuadër të projektit “Cilësi dhe barazi në arsim”, në shumën **62.6 milion lekë**, realizuar në shumën **30.74 milion lekë**

Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin 2011, në këtë program është në masën 92 % dhe përfaqëson rreth 2% të totalit të shpenzimeve të realizuara sipas zërave kryesore. Krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime korente	96 %
Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale	55%
Gjithsej	92 %

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet ne tabelën:

Kodi i Prod	Emri i Produktit	Buxhet Plan 2011	Buxheti Vjetor Rishikuar 2011	Fakti 12 mujor 2011	Realizimi %
B	Krijimi i kushteve te punes per punonjesit ne MASH,DAR/ZA.	196,510.0	129,319.7	129,137	100%
C	Trajnimit te punonjesve ne MASH, DAR/ZA/Inspektoriat per ritjen e kapaciteteve te burimeve njerzore.	10,055.0	6,055.0	5,276	87%
D	Krijimi i sistemit te Monitorimit, Trajnimi i punonjesve te MASH, DAR/ZA ne kuader te sistemit EMIS.	1,000.0	1,000.0	874	87%
H	Vleresimi i punes se punonjesve ne MASH,DAR/ZA.	636,715.0	550,102.6	527,568	96%
K	Auditimi dhe inspektimi institucioneve te Sistemit te Arsimit	15,000.0	15,000.0	14,790	99%
J	Forcimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese, nËpËrmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese projektit "Cilesi dhe Barazi"	17,735.0	18,838.0	14,976	80%
L	Trajnimi i drejtoresve te shkollave qe aplikojne autonome financiare	16,500.0	0.0	0	0%
A	Blerja e softve informatike per sherbimet ne MASH,DAR/ZA	15,700.0	14,000.0	0	0%
E	Ndertime te reja dhe konstruksione per permiresimi i infrastruktures ne MASH, DAR/ZA	3,200.0	0.0	0	0%
F	Rikonstruksioni dhe zgjerimi i mjediseve ekzistuese ne MASH, DAR/ZA	18,130.0	17,630.0	14,753	84%
G	Blerja e pajisjeve elektronike/ informatike per sherbimet ne MASH,DAR/ZA	50,500.0	48,600.0	30,737	63%
I	Hartimi dhe Dizajnimi i projekteve te reja ndertimore dhe te projekte per rikonstruksionine objekteve ne ne DAR/ZA.	790.0	390.0	390	100%
M	Blerja e pajisjeve e mobileri zyre per krijimin e kushteve te punes ne MASH,DAR/ZA	6,680.0	6,680.0	2,130	32%
		988,515.0	807,615.3	740,567.3	92%

Disa nga aktivitetet qe nuk jane realizuar per kete periudhe;

1. Trajnimi i punonjesve ne MASH, DAR/ZA/Inspektoriat per rritjen e kapaciteteve te burimeve njerzore, si dhe per shak te rishikimit te buxhetit 2011.
2. Krijimi i sistemit te Monitorimit, Trajnimi i punonjesve te MASH, DAR/ZA ne kuader te sistemit EMIS,
3. Blerje pajisje informatike dhe elektronike per sistem EMIS ne MASH dhe DAR/ZA (CBA), procedurat jane ne proces.

FaktorËt qe kanË ndikuar ne realizimin e buxhetit per vitin 2011;

1. Miratimi i planit te aktiviteteve per vitin 2011 ne muajin Mars, ne kuader te projektit "Cilesi dhe Barazi ne Arsim", e per pasojË shtyrja e afatit te prokurimeve per disa aktivitetet ne kuader te projektit "Cilesi dhe Barazi ne Arsim", te cilat kanË zËnË njË peshË te konsiderueshme ne PVR dhe ne buxhetin e MASH.
2. Miratimi me vonesË i fondit te zhvillimit te rajoneve per vitin 2011, si dhe rishikimi i ligjit vjetor te buxhetit per vitin 2011
3. Rishikimi i buxhetit per vitin 2011, ka detyruar institucionet te ndËrpresin kontratat ose te shtyjnË pagesat e detyrimeve te linduara ne vitin 2011 per tu paguar/likujduar ne vitin 2012
4. VKM nr.595, datË 24.8.2011 "PËr disiplinimin e fondeve buxhetore per vitin 2011".
5. VKM nr. 826, datË 5.12.2011 "PËr njË ndryshim ne VKM nr. 929, datË 17.11.2010 "PËr krijimin dhe pËrdorimin e fondit te veçantË", ndryshimi i pikËs 9-tË ne kËtË vendim pËrjashton dhËnien e shpËrblimeve te punonjesve per rezultate ne punË dhe veprimtari social- kulturore.

II - ARSIMI BAZË. (Titulli buxhetor i programit 09120)

Buxheti per kete program per vitin 2011 ËshtË **23 miliard e 636.6 milion** lekË, realizimi shpenzimet te buxhetit per periudhËn 12 mujore ne kete program ndaj planit vjetor ËshtË ne masËm **97%**. Buxheti i arsimit bazË ndaj buxhetit pËrfaqËson rreth 61% te fondeve te arsimit dhe 61.7% te totalit te shpenzimeve te realizuara.

Objektivat kryesore :

Sigurimi i një arsimit cilësor dhe për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies si dhe duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar.

Objektivi 1 - Zgjerimi i arsimit parashkollor me synimin përfshirjen e të gjithë fëmijëve 5 vjeçar në vit përgatitor. Për këtë vit parashikohet një rritje e aksesit të fëmijëve 5 vjeçar me 10% Modernizimi i arsimit parashkollor, përmes trajnimit të mësuesve (20% në vit), rikonstruksionit dhe ndërtimit (150 -200 klasa në vit) të kopshteve dhe pajisjes me bazë materiale didaktike

Objektivi 2 - Hartimi i kornizës kurrikulare të AB (kl1-9), realizimi i studimit krahasues i kurrikulës së arsimit bazë, realizimi i studimit të të gjitha kurrikulave lëndore (kl1 – 12) . Trajnimi i mësuesve të AB për zbatimin cilësor të kurrikulës (trajnimi 6000 punonjësve mësimorë në vit për 25 % të mësuesve).

Përmirësimi i cilësisë së teksteve shkollore të AB në zbatim të reformës si dhe kompensimi i rreth 118 842 nxënësve në zbatimin e VKM Nr 107, datë 10.02.2010, i ndryshuar.

Objektivi 3 - Sigurimi i aksesit për shkollën për fëmijët e shtresave të marginalizuara si dhe ulja e treguesit për braktisjen shkollore (nga 0.4% deri në 0.35%), rritja me 4.5% e regjistrimit të nxënësve romë egjiptian.

Objektivi 4 - Zgjerimi dhe konsolidimi i shërbimit psikologjik shkollor (një psikolog për 2 000 nxënës), në funksion të përmirësimit të procesit të mësimnxënies dhe edukimit në AP dhe AB. Trajnimi i mëtejshëm i 230 psikologëve.

Objektivi 5 - Rehabilitimi dhe ndërtimi kopshteve dhe shkollave të reja, sipas standardeve (arritja e objektivit deri në 30 nxënës/klasë. Pajisja e 25% të shkollave të AB me laborator shkencorë, me laborator IT për të siguruar një kompjuter për dy nxënës, në çdo orë mësimi. Të sigurohen laboratorë virtual dhe biblioteka dixhitale për zbatimin e kurrikulës në AB (të paktën 1 set laptop-projektor për çdo shkollë).

Arritje për vitin 2011:

- ✚ Përgjatë vitit 2011, si dhe në vazhdimësi po ndërmerret një ndërhyrje e thellë në kurrikulën e arsimit parauniversitar me qëllim modernizimin e përmbajtjes së teksteve shkollore dhe përshtatjen e programeve mësimore me kërkesat e shoqërisë së dijes dhe informacionit si dhe kërkesat e tregut të punës. Në vitin 2012 pritet miratimi i projekt-ligjit për arsimin parauniversitar (15 shkurt 2012 në Këshillin e Ministrave), amendimet e të cilit do të sjellin risi dhe rritjen e cilësisë në sistemin arsimor shqiptar. Teknologjia e informacionit (IT) është shtrirë gjerësisht në sistemin arsimor, duke u bërë kështu motori i modernizimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollat shqiptare.
- ✚ Sistemi i arsimit parashkollor përfaqësohet nga një rrjet i gjerë i institucioneve parashkollore, me dhe pa ushqim, publik dhe privat të cilat frekuentohen nga 78.767 fëmijë të moshës 3-5 vjeçare (rreth 64% e grup moshës). Në vitin shkollor 2011-2012, me hapjen e 400 klasave përgatitore, 81% të fëmijëve të regjistruar në klasë të parë kanë ndjekur të paktën një vit përgatitor. Procesi mësimor edukativ në arsimin parashkollor zhvillohet sipas programeve edukative të reformuara në bazë të standardeve bashkëkohore.
- ✚ Sa i përket arsimit bazë të detyruar (klasat 1-9), treguesit statistikorë pasqyrojnë një përqindje të lartë të nxënësve që përfundojnë me sukses arsimin e detyruar. Rreth 91.5% e nxënësve që përfunduan arsimin e detyruar, vijuan arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe atë profesional (*progression rate*). Në zonat urbane, ky tregues është rreth 96%, ndërsa në zonat rurale është ende 81%. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në konsultim të gjerë me grupet e interesit dhe grupet e punës të përbërë nga mësues, prindër, dhe ekspertë në çdo rreth të vendit është angazhuar për hartimin e kornizës kurrikulare (klasat 1-9) dhe për vendosjen e standardeve moderne në programet lëndore. Kurrikula e re do të sjellë disa lehtësira duke minimizuar mbingarkesën mësimore, nëpërmjet integritit lëndor të dy ose tri lëndëve që janë të të njëjtit profil, si ai shkencor. Për përmirësimin e mësimdhënies në shkollat e arsimit bazë, është trajnuar stafi mësimor për përdorimin e pajisjeve dixhitale dhe teknologjike, me qëllim realizimin e orës mësimore në laboratorë virtualë, ku shtohet elementi audio-visual i të spjeguarit dhe të nxënies.
- ✚ Në vitin 2012, klasa 9 e arsimit bazë do t'i nënshtrohet testimit ndërkombëtar të PISA në lëndën e matematikës.
- ✚ Krahas arritjeve, Ministria e Arsimit dhe Shkencës përballlet me sfida në arsimin parashkollor dhe arsimin bazë. Disa nga sfidat kryesore vazhdojnë të jenë sigurimi i cilësisë në kopshte dhe shkolla (cilësia në infrastrukturë dhe në kurrikulë), ulja e braktisjes në shkollë, trajnimi i vazhduar i mësuesve dhe rritja e një menaxhimi eficient dhe transparent akademik dhe financiar në çdo shkollë.

- ✚ MASH po zbaton 13 projekte për shtrirjen e teknologjisë së informacionit në arsim që i shërbejnë fazës së dytë, asaj të çuarjes së internetit në çdo klasë dhe mësimin të mbështetur në teknologjinë e informacionit.
- ✚ **TIK.** Në kuadër të programit Cilësi dhe Barazi në Arsim (CBA), MASH ka organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) për stafin e IT në DAR/ZA në lidhje me përdorimin e TIK në arsim, për mirëmbajtjen e kompjuterave dhe të rrjetit informatik. Janë trajnuar gjithsej 115 specialistë të IT në nivel DAR/ZA. Gjithashtu, janë trajnuar 1100 mësues të të gjithë disiplinave (lëndëve) të sistemit arsimor parauniversitar për aftësimin e tyre në përdorimin e IT si mjet për integrimin e teknologjisë në programet mësimore. Janë trajnuar të gjithë mësuesit e lëndes së TIK në shkollat e arsimit profesional në kurse të profilizuara për mirëmbajtje të kompjuterit dhe të rrjetit kompjuterik.
- ✚ Gjatë vitit 2011 filloi ndërtimi dhe rindërtimi i 131 objekteve arsimore (kopshte, shkolla, shkolla).
- ✚ Investim tjetër shumë i rëndësishëm, në kuadër të projektit CBA, është edhe ai për ngritjen e laboratorëve mësimorë. U siguruan 360 laboratorë të biologjisë dhe kimisë për shkollat e mesme dhe ato 9-vjeçare.
- ✚ U dhanë falas tekstet shkollore për të gjithë nxënësit e komunitetit rom, nxënësit e pakicave kobëtare, nxënësit që nuk shikojnë ato për nxënësit e familjeve që marrin ndihmë sociale, pra u rimbursuan 100%. U përgatitën zhvilluan procedurat e blerjes dhe u dërguan në Ministrinë e Jashtme 8500 tekste mësimore për fëmijët e emigrantëve që jetojnë në Greqi, Itali Angli etj. **Për herë të parë janë blerë (me fonde nga donatorët) dhe libra Abetare për fëmijët e Lugniës së Presheves.**
- ✚ Në arsimin parashkollor do të vazhdojë puna për rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në kopshte, në mënyrë të veçantë të fëmijëve 5 vjeç në klasat përgatitore.
- ✚ Do të vazhdojë puna me projekte për uljen e mëtejshme të braktisjes së shkollës. Në këtë kuadër, përparësi do të ketë përkujdesja përmes masave të ndryshme, si tekstet dhe transporti falas etj. për nxënësit e familjeve në nevojë, në mënyrë të veçantë të fëmijëve të komunitetit rom dhe atyre të familjeve në nevojë.
- ✚ Këtë vit përfundon hartimi i platformës së reformës së përmbytjes, pra të kurrikulës, së arsimit bazë. Mësuesit dhe pedagogët më të mirë janë angazhuar në grupet e punës për hartimin e planit mësimor dhe të programeve. Kjo platformë do t'i nënshtrohet një diskutimi shumë të gjerë me mësuesit, prindërit, grupet e interesit dhe ekspertët në çdo rreth të vendit.
- ✚ Sistemi i arsimit bazë do t'i nënshtrohet vlerësimit për lëndën e matematikës, në kuadër të vlerësimit ndërkombëtar PISA 2013.
- ✚ Përfundimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Informacionit (EMIS) në arsimin parauniversitar dhe atë universitar do të mundësojë rritjen e eficiencës dhe transparencës në menaxhimin akademik dhe financiar në gjithë sistemin, që nga niveli i shkollës deri tek ai qendror.

Shpenzimet korente janë planifikuar u realizuan sa vijon;

Fonde për shpenzime personeli “Pagat dhe sigurimet shoqërore në artikullin 600 – 601”, janë planifikuar në shumën **20 miliard e 695.2 milion lekë** për pagesat e **30,173 punonjësve të arsimit 9-vjeçar** nga të cilët 27 888 punonjës mësimorë dhe 2 285 punonjës ndihmës për shërbime mbështetëse, për rreth 399 504 nxënësve në arsimin 9-vjeçar dhe rreth 71 670 fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor. Shpenzimet për shpenzime personeli janë realizuar në masën **99 %** ndaj planit 2011 ose **20 miliard e 392.2 milion lekë** lekë.

Zëri i shpenzime operative (artikulli 602-606), janë planifikuar 687.1 milion lekë dhe janë realizuar në shumën 678.1 milion lekë ose në masën 100%, nga të cilat:

- ✚ Shpenzime për Institutet speciale, Instituti i fëmijëve që nuk dëgjojnë si dhe Instituti i fëmijëve që nuk shikojnë, 23.5 milion lekë, **dhe janë realizuar në shumën 23.3 milion lekë ose në masën 100%.**
- ✚ Shpenzime për Instituti i Kurikules dhe Trajnimeve Tiranë **18.9 milion lekë;**
- ✚ Shpenzime për transportin e 13.800 mësuesve dhe 26.800 nxënësve për rreth **460 milion lekë (afro 209 milion lekë detyrime të vitit 2011 janë kaluar për tu likuiduar me buxhetin e vitit 2012);**
- ✚ Shpenzime për blerjen e mjetet didaktike, **9 milion lekë** (CBA për klasat përgatitore)
- ✚ Shpenzime për trajnime të mësuesve në DAR/Za- **18.5 milion lekë;** (CBA janë trajnuar rreth 3077 punonjës mësimorë nga të cilët 66 punonjës në IT me vlerën 4.3 milion lekë, trajnimi i rrjetëve lokale për kurrikulën e klasës 11-12 në shumën 6.5 milion lekë, trajnimi i 616 punonjësve për klasën e 12-të me shumën 4.9 milion lekë, trajnim i mësuesve për përdorimin laboratorit kimie-biologji)
- ✚ Shpenzime për trajnime të mësuesve në DAR, për nxënës nga shtresat e marxhinalizuara, si dhe uljen e braktisjes 2.1 milion lekë;
- ✚ Shpenzime për blerje dokumentacion shkollor DAR/ZA, **12 milion lekë,**

- ✚ Shpenzime për Vlerësimi i teksteve shkollore si dhe veprimtaria e KMT 2011 librit shkollor – honorare vlerësimi ,komisioni i vlerësimit , shërbime hotelerie vlerësuesve **3 milion lekë**
- ✚ Shpenzime për blerje pulla me hologram **4 milion lekë**,
- ✚ Në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në arsim për implementimin e skemës së financimit të shkollave përmes granteve aktivitete të pilotuar në 80-120 shkolla, aktivitete në drejtim të përmirësimit të kurrikulës, kualifikimit përmes trainimeve etj ishin parashikuar **42 milion lekë** për aktivitete në MASH(ky aktivitet vazhdon në vitin 2012).
- ✚ **Shpenzime për në artikullin 606, - Kompesimi i blerjes së teksteve shkollore për rreth 120 mijë nxënës - 214.3 milion lekë dhe janë realizuar në shumën 214.3 milion lekë osenë masën 100%.**

Shpenzimet për investime kapitale në programin Arsimi Bazë, janë 2 miliard e 260 milion lekë (nga të cilat 1.16 miliard lekë financim i brendshëm dhe 1.1 miliard lekë me burim financim të huaj)

- ✚ Investime pjesë e fondit të zhvillimit të rajoneve 2011, janë planifikuar 782.45 milion lekë përfshirë detyrimet ndaj vitit 2010 për objektet në vazhdim për rreth 211 milion lekë, realizuar për 12-mujorin rreth 200.2 milion lekë, blerje pajisje mobilierie 24.5 milion lekë për objektet e përfunduara në vazhdim nga viti 2010,për të cilat janë kryer procedurat e prokurimit dhe janë realizuar 100%, sipas kontratave të lidhura me 23 milion lekë). Janë çelur objektet nga lista prioritare me objektet e vlerësuara në gjendje emergjente, nga të cilat janë përzgjedhur 88 objekte në arsimin bazë, me vlerë totale 1.333 miliard lekë me financim për vitin 2011 rreth 486.5 milion lekë, janë lidhur kontratat për rehabilitime të objekteve emergjente me financim për vitin 2011 rreth 277.7 milion leke, realizuar me 246.8 milion leke dhe ndërtime të reja me financim 218.1 milion lekë, realizuar 207.9milion leke
- ✚ Investime në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim me vlerë financimi 1.365 miliard lekë, të realizuara në total me 1.015 miliard lekë
- ✚ Ndërtime të reja (finansim - 9 objekte shkolla në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim) me vlerë financimi 569.1 milion lekë, me realizim në vlerë prej 455.8 milion lekë
- ✚ Rehabilitime në kuader të projektit ”Cilësi e barazi në arsim” për 7 projekte me vlerë 324.5 milion lekë, me realizim në vlerë 309 milion lekë.
- ✚ Studim projektim me vlerë 23.6 milion lekë realizuar 23.1 milion lekë
- ✚ Pajisje mobilje për shkollat e reja dhe të rehabilituara në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim me vlerë prej 44.5 milion lekë, alokuar pushtetit vendor për pajisjen e shkollave të përfunduara, ndërtime dhe rehabilitime, realizimi 33 milion lekë.
- ✚ Pajisje mobilje për klasat përgatitore në arsimin parashkollor në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim me vlerë 37.4 milion lekë me kontrate të realizuar me vlerë 36.9 milion lekë.
- ✚ Pajisje kompjuterike – 32.5 milion lekë në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim, kanë përfunduar procedurat e prokurimit, janë lidhur kontratat, por nuk janë realizuar.
- ✚ Laboratore virtuale të lëvizshëm 40.6 milion lekë në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim janë realizuar 22.1 milion lekë
- ✚ Detyrime dhe Lidhja me internet - 38 milion lekë, nuk u realizua
- ✚ Pajisje laboratorike kimie, fizike, biologji – 115 milion lekë (në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim) realizuar 60.5 milion lekë.
- ✚ Mobileri për laboratore shkencore 40 milion leke janë realizuar procedurat e prokurimit dhe janë lidhur kontratat, por nuk ka realizim.
- ✚ Pajisje mobilierie për kompjutera - 54.2 milion lekë në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim, realizuar me vlerë 30 milion lekë.
- ✚ Fond për shpronësim 17.5 milion lekë i realizuar 100%
- ✚ Bibliotekat shkollore - 50 milion lekë, janë realizuar 46.1 milion lekë.
- ✚ TVSH dhe Kosto Lokale për shkollat e rehabilituara në arsimin e bazë 62.5 milion lekë, realizuar 45.3 milion lekë.

Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin 2011 në këtë program është në masën 97% dhe përfaqëson rreth 61% të fondeve të arsimit dhe 61.7% të totalit të shpenzimeve të realizuara për MASH. Krahasuar me planin e rishikuar për 2011 rezultojnë si më poshtë:

Shpenzimet korente	99 %
<u>Shpenzimet kapitale</u>	<u>80 %</u>
Gjithsej	97 %

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor paraqitet në tabelën në vijim

Në mijë lekë

Kodi i		Buxheti Vjetor	Buxheti Rishikuar 2011	Fakti 12 mujor	Realizim %
Produktit	Emri i Produktit	2011		2011	
A	Shkolla të rehabilituara në arsimin bazë	797,156.0	664,809.0	601,246.0	90%
A	Biblioteka shkollore të krijuara sipas standardeve	50,000.0	50,000.0	46,111	92%
A	Laboratorë kimie, fizike, biologjie të pajisur dhe funksionalë	214,450.0	115,000.0	60,488	53%
A	Projekte ndërtimore të hartuara dhe dizenuara sipas standardeve.	0.0	40,000.0	0	0%
A	Blerje pajisje, mobilim i klasave të reja/rehabilituara.	0.0	23,624.0	23,147	98%
A	Shkolla të reja të ndërtuara sipas parametrevave të kërkuar	230,000.0	68,997.0	56,105	81%
A	Kabinetet e informatikës të krijuara	955,201.0	838,186.0	691,200	82%
K	Ndërtimi i kopshteve të reja	0.0	62,540.0	45,302	72%
L	Kopshteve/shkolla të rehabilituara për Rritjen e aksesit të fëmijëve 5 vjeçar me 10% dhe fëmijëve 3-4 vjeçarë	139,500.0	165,645.0	52,142	31%
M	Kopshte të mobiluara me mobilje e orëdi etj	78,000.0	100,000.0	98,741	99%
N	Krijimi i kabinetëve të psikologëve, furnizim me pajisje e orëdi	240,000.0	93,863.0	91,000	97%
A	Rritje e aksesit të fëmijëve 5 vjeçar me 10% dhe fëmijëve 3-4 vjeçarë	35,000.0	37,400.0	36,900	99%
B	Realizimi i shërbimit arsimor në sistemin parashkollor	17,000.0	0.0	0	0%
C	Realizimi i shërbimit arsimor në sistemin 9 vjeçar, për përmbushjen e funksioneve të edukimit dhe realizimin e misionit të	24,500.0	24,500.0	24,500	100%
D	Hartimi i kornizës kurrikulare të AB (kl1-9), Kurrikula të rishikuara dhe të rivlerësuar të Arsimit të Bazë.CBA (Instituti Zhvillimit të Arsimit)	2,549,680.0	2,549,680.0	2,523,760.7	99%
E	Trajnimi i mësuesve të arsimit bazë.	18,139,437.0	18,239,127.0	17,967,343.3	99%
F	Kompesimi financiar i teksteve shkollore për arsimin bazë.	58,500.0	54,832.0	46,277	84%
H	Shërbim transporti për nxenes dhe mësues.	11,500.0	21,600.0	21,563	100%
J	Tranimi i mëtejshëm i psikologëve shkollor	210,000.0	214,448.0	214,448.0	100%
TOTALI		24,171,994.0	23,636,321.0	22,872,344.2	97%

Nga tabela e mësipërme del që disa produkte nuk janë realizuar për 12 mujorit 2011;

- Shkolla që përfitojnë autonomi financiare, nuk janë realizuar procedurat e prokurimit, vazhdon aktivitetit në vitin 2012;
- Produktet të planifikuara për vitin në grupin e investimeve kapitale, nuk janë realizuar procedurat e prokurimit publik për shkak të vonësive në miratimin të fondit të zhvillimit të rajoneve për vitin 2011.
- Projekte ndërtimore të hartuara dhe dizenuara sipas standardeve, për shkak të ndryshimit të procedurave për objektet apo kontrata në vazhdim si dhe projektet e reja si me fondet e buxhetit të shtetit dhe me fondet në kuadër të projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim";

Faktorët që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 12 mujorit 2011:

- Shpërndarja me vonësë të fondit të zhvillimit të rajoneve për investimev për vitin 2011 me përfitues njësitë e pushtetit vendor, me ndikim në miratimi me vonësë i planit të investimeve për vitin 2011, si dhe zhvimmimin e procedurave.
- Miratimi me vonësë i planit të aktiviteteve në kuadër të projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim", në muajin Mars nga bankat donatore dhe Prill nga MF, e për pasojë shtyrja e afatit të prokurimeve për realizimin e disa aktiviteteve në kuadër të projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim", të cilat kanë zënë 50% në buxhetin e MASH.
- Mosrealizim i procedurave dhe praktikave lidhur me programin e pilotimit të shkollave që përfitojnë autonomi financiare.
- Rishikimi i buxhetit për vitin 2011, ka detyruar institucionet të ndërpresin kontratat ose të shtyjnë pagesat e detyrimeve të lindura në vitin 2011 për tu paguar/likujduar në vitin 2012. Disa nga aktiviteteve të projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim", janë në proces procedurat e prokurimit për vitin 2011 dhe vazhdojnë në vitin 2012.
- VKM nr.595, datë 24.8.2011 "Për disiplinimin e fondeve buxhetore për vitin 2011".(Për fondet e planifikuara për trajnime jashtë vendit etj.)
